

Nr. Serisë \_\_\_\_\_

Datë e lëshimit \_\_\_\_\_

**POLICË PËR SIGURIMIN E PËRGJEGJËSISË SË DREJTUESIT TË MJETIT MOTORIK, QE DREJTON MJETIN NËN  
EFEKTIN E ALKOLIT OSE ME LEJE DREJTIMI TË KUFIZUAR  
“TPL PLUS”**

SIGURUESI: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Dega/Agjensia: \_\_\_\_\_

Adresa/Tel/email: \_\_\_\_\_

|              |                      |             |                 |                       |
|--------------|----------------------|-------------|-----------------|-----------------------|
| Pronësia:    | Nipti / Kodi Fiskal: |             |                 | Përfituesi:           |
| I siguruari: | Gjinia:              | Datëlindja: | Dëshmi aftësie: | Adresa / Tel / email: |
|              |                      |             |                 |                       |

**MJETI MOTORIK**TPL: Shoqëria **SIGAL**, Nr. Serie: \_\_\_\_\_ Periudha e sigurimit: nga \_\_\_\_\_ deri \_\_\_\_\_.

| Targa | Kategoria | Klasa | Marka | Modeli | Ngjyra |
|-------|-----------|-------|-------|--------|--------|
|       |           |       |       |        |        |

| Viti i prodhimit | Numri i shasisë | Numri i vendeve | Kapaciteti mbartës | Fuqia motorike |
|------------------|-----------------|-----------------|--------------------|----------------|
|                  |                 |                 |                    |                |

**SIGURIMI**

| Rreziqet e Siguruara       |                                            | Limiti i dëmshpërblimit(ALL)                                    | Pjesa e zbritshme* | Franshiza (në %) | Primi      |
|----------------------------|--------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|--------------------|------------------|------------|
| 1.                         | Drejtim mjeti nën efektin e akoolit        | Dëme materiale, deri në vlerën e parashikuar në ligjin 32/2021. | 20%                | 0%               | 2,000 Lekë |
| 2.                         | Drejtim mjeti me leje drejtimi të kufizuar | Dëme materiale, deri në vlerën e parashikuar në ligjin 32/2021. | 20%                | 0%               | 2,000 Lekë |
| Periudha e Sigurimit       |                                            | nga ora 24.00 datë _____ deri ora 24.00 datë _____              |                    |                  |            |
| Primi i Shkruar **         |                                            |                                                                 |                    |                  |            |
| Taksa mbi primin e shkruar |                                            |                                                                 |                    |                  |            |
| Totali                     |                                            |                                                                 |                    |                  |            |

**Kjo kontratë sigurimi është e vlefshme vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.**

\* Nëse i siguruari është palë e dëmtuar, i mbahet vetëm 10% e vlerës për shpenzime administrative e cila zbritet nga vlera totale e dëmit.

\* Ligji Nr. 127/2016 datë 15.12.2016

Në primin e shkruar përfshihet dhe tarifa e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në masën 1.5%, në bazë të ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006, i ndryshuar.

**Pëlqimi për Përpunimin e të Dhënave** - Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe/ose pagesën e primit sigurimit, unë subjekti i të dhënave personale me qëllim përmbushjen e kontratës jap pëlqimin tim në mënyrë eksplicite për përpunimin e të dhënave personale (përfshirë të dhënat identifikuese, shëndetësore dhe financiare) nga SIGAL, ekskluzivisht për qëllimet e vlerësimit të rreziqeve, administrimit të kontratës sigurimit, përpunimit të kërkesave dhe respektimit të detyrimeve ligjore sipas Ligjit Nr. 124/2024 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Të dhënat mund të ndahen me palët e treta të autorizuar dhe ruhen për 7 vite pas përfundimit të kontratës sigurimit. Jam njohur me të drejtën për tu informuar për të dhënat, për t'i korrigjuar ato, ose për të tërhequr pëlqimin. Miratimi i posacen e jap edhe kur keke produkt e blej online. Jap pëlqimin ☒

Për sa më sipër nënshkruajnë personat e autorizuar nga Siguruesi dhe i Siguruari:

PRONARI / I SIGURUARI:

&lt;&lt;[p.Beneficiaries[0].DisplayName]&gt;&gt;

(Emri, Mbiemri, Firma)

AGJENTI:

&lt;&lt;[p.RelatedAgency]&gt;&gt;

(Emri, Mbiemri, Firma)

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Ayni PONARI



**Shoqëria e Sigurimeve SIGAL UNIQA Group Austria**, në përputhje me kushtet, përcaktimet, përjashtimet dhe parashikimet e Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit (sipas mbulimeve të kërkuara nga vetë i Siguruari) gjatë periudhës së sigurimit, kundrejt pagesës së primit të sigurimit Nënshkrimi i policës sigurimit nënkupton se i siguruari ka disponuar, kuptuar dhe pranuar me vullnet të lirë të gjitha termat dhe kushtet e kontratës të sigurimit. I siguruari në respekt të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nëpërmjet nënshkrimit të policës sigurimit jep pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale nga Siguruesi me qëllim përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve kontraktore si dhe transferimin e tyre tek palë të treta

**Kushtet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë së drejtuesit të mjetit që drejton mjetin nën efektin e alkoolit ose me leje drejtimi të kufizuar për kategorinë e mjetit motorrik**

#### 1. Objekti i Sigurimit

Objekt i kësaj kontrate është **sigurimi shtese i përgjegjësisë së drejtuesit të mjetit motorrik** për dëmet materiale ndaj paleve të treta për të cilat ligji për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit ka parashikuar përjashtimin nga mbulimi në sigurim. Sigurimi shtesë i përgjegjësisë mbulon dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjetit në rastet e mëposhtme: - Drejtuesi i mjetit drejton mjetin **nën efektin e alkoolit** ose me **leje drejtimi të kufizuar për kategorinë e mjetit**.

Këto raste përcaktohen sipas: - Nenit 117/1 të Kodit Rrugor. - Nenit **184**, pika **2.a)** dhe **b)** të Kodit Rrugor raste për të cilat siguruesi nuk ka të drejtë të kërkojë nga i siguruari kthimin e shumës që ka paguar ndaj palës tretë.

#### 2. Përkufizimet

**a. Siguruesi** - Është lëshuesi i policës së sigurimit që merr përsipër rreziqet e lidhura me ngjarjen e sigurimit dhe detyrohet të paguajë dëmshpërblimin në rast të ndodhjes së saj.

**b. I Siguruari** - Është personi fizik ose juridik (**policëmbajtësi**) që lidh marrëdhënien ligjore me siguruesin për të mbrojtur interesin e tij pasuror në rast të ngjarjes së sigurimit, duke siguruar mbulimin nga siguruesi të dëmeve qe ai shkakton nën ndikimin e alkoolit apo patentës së kufizuar për mjetin motorrik, sipas parashikimeve të kësaj kontrate.

**c. Përfaqësuesi** - Personi fizik/juridik i autorizuar për lidhjen dhe nënshkrimin e kontratës së sigurimit. **Kujdes:** Vetëm personi i shënuar në policën e sigurimit ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim sipas kushteve të kontratës.

**d. Reziku i Mbuluar në Sigurim** - Mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje sigurimi për të cilën siguruesi merr përgjegjësi sipas kushteve të kontratës.

**e) Dëm material** - Konsiderohet dëmi i shkaktuar drejtpërdrejt pronës apo mjetit të palës së tretë që dëmtohet nga aksidenti në drejtim të mjetit të siguruar. Dëmi material në kuptim të kësaj police nuk konsiderohet dëmi pasuror apo ekonomik në përgjithësi, dhe as ai jopasuror.

**ë) Mjeti motorrik** - Ka të njëjtin kuptim të dhënë në ligjin nr.32/2021 Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit

**f) MTPL** - Sigurimi i përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorrik sipas ligjit nr.32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

#### 3. Shtrirja Territoriale dhe Afati i Sigurimit

**Mbulimi territorial:** - Kjo Policë ka efekt ligjor **vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë**.

**Afati i sigurimit:** - **1 vit** (periudhë vjetore). Lëshohet së bashku me policën e sigurimit të detyrueshëm **MTPL të shoqërisë SIGAL**. Hyn në fuqi në **datën dhe orën e shënuar në policë** si "datë fillimi". Skadon në **datën dhe orën e shënuar në policë** si "datë mbarimi", e njëjtë me skadencën e policës MTPL.

**Kufizimet e mbulimit:**- Mbulimi është i vlefshëm për **maksimum 2 ngjarje sigurimi** gjatë periudhës së sigurimit dhe përkatesisht 1 (një) ngjarje sigurimi kur drejtuesi i mjetit drejton mjetin **nën efektin e alkoolit** dhe 1 (një) ngjarje sigurimi kur drejtuesi i mjetit drejton mjetin me **leje drejtimi të kufizuar për kategorinë e mjetit**.

- **Kontrata pushon efektet automatikisht** nëse i siguruari ka përfutur dëmshpërblim për **2 ngjarje sigurimi** brenda afatit të saj.

#### 4. Dëmet e Mbuluara

Siguruesi mbulon **dëmet materiale të pronës së paleve të treta** të shkaktuara nga i siguruari, në kushtet e mëposhtme:

**a. Kushtet e përgjithshme:** - I siguruari ka **paguar primin shtesë të sigurimit** për këtë policë dhe primin e sigurimit **MTPL-se të leshuar SIGAL** për të njëjtin mjet. - Dëmshpërblimi nuk kalon kufirin e përcaktuar në policë si shumë sigurimi .

**b. Rastet specifike të mbulimit:** 1.**Drejtimi i mjetit motorrik** nga: - Një person me **leje drejtimi vendase të grupit "A"** (në 3 vitet e para të lëshimit). - **Kufizimi i fuqisë:** Mjetet me fuqi **25 kW specifike ose më shumë** (0.16 kW/kg ose më shumë) **nuk janë të mbuluara**. 2.

**Drejtimi i mjetit motorrik** nga: - Një person me **leje drejtimi të kategorisë B** (në 2 vitet e para të lëshimit). - **Në drejtim të mjeteve me fuqi më shumë se:** - **55 kW/tonë** (për mjetet me motor me dëgjie të bredshme). - **65 kW/tonë** (për mjetet hibride ose plug-in, duke përfshirë peshën e baterisë). 3. **Drejtimi i mjetit** nga: - Një person i konstatuar nga sherbimet e policisë nën ndikimin e alkoolit, kur përqendrimi i alkoolit në ajrin qe del nga frymemarrja është **deri në 0.5 g/l (gram për litër) (neni 184.2/a) dhe b)** ose ose vlera që barazohet me të, të nivelit të alkoolit në gjak kur analiza bëhet nga gjaku.

#### 5. Përjashtimet nga Mbulimi

Siguruesi nuk mbulohet për dëmet e mëposhtme të shkaktuara nga i siguruari ndaj paleve të treta:

**a. Dëmet materiale mbi kufijtë ligjorë** - Dëmtimet që kalojnë kufirin ligjor të dëmshpërblimit për sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorrik, sipas ligjeve në fuqi.

**b. Dëme pasurore dhe jopasurore me pasojë shëndetësore;** Përfshijnë: - Vdekjen, dëmtimet fizike ose përkëqësimin e shëndetit të palëve të treta. - Dëmet morale, humbjen e fitimit, ose çdo dëm tjetër jo-material, financiar apo ekonomik.

**c. Dëmet e shkaktuara qëllimisht** - Dëmet e shkaktuara qëllimisht ose me dashje nga i siguruari ndaj pronës së palëve të treta.

**d. Drejtuesi i paautorizuar** - Dëmet shkaktuar nga drejtuesi i mjetit që nuk është i shënuar në policën e sigurimit si person i mbuluar/siguar.

**e. Shkelje e kushteve ligjore të drejtimit** - Dëmet nga drejtuesi i mjetit që nuk ka të drejtë ligjore për drejtimin e mjetit, përveç rasteve të parashikuara në pikën 4 të kësaj kontrate.

#### 6. Primi i Sigurimit

**a. Përcaktimi dhe Pagesa** - Primi i sigurimit përcaktohet nga Siguruesi në policën e sigurimit dhe duhet paguar nga i Siguruari para hyrjes në fuqi të kontratës. - Pagesa bëhet njëherësh dhe në tërësi me nënshkrimin e policës së sigurimit MTPL dhe kësaj police.

**b. Pasojat e Mospagimit** - Nëse primi nuk paguhet para datës së fillimit të mbulimit: - Kontrata pezullohet automatikisht dhe nuk krijon efekte juridike për Siguruesin. - Nëse primi paguhet brenda 24 orëve nga data e fillimit, kontrata aktivizohet në atë datë.

Nëse primi nuk paguhet brenda 30 ditëve kalendarike: - Kontrata shuhet automatikisht pa nevojë për njoftim shtesë.

**c. Kushtet e Pezullimit/Rinovimit;** - Gjatë pezullimit (30 ditët e para), Siguruesi nuk ka asnjë detyrim mbulimi. - Pas shuarjes së kontratës, për riaktivizim kërkohej lidhje e një kontrate të re.

#### 7. Dëmshpërblimi i Sigurimit

**a. Përcaktimi i dëmshpërblimit:** - Dëmshpërblimi ndaj palës tretë llogaritet bazuar në **vlerën e dëmeve materiale** (dëme ndaj pronës) të shkaktuara, të vërtetuara me aktet ligjore/nënligjore për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit dhe rregulloren e AMF. - Nuk mund të kalojë **kufirin** e përcaktuar në policën e sigurimit , si përgjegjësia e pronarit/drejtuesit të mjetit sipas ligjit.

**b. Detyrimet e Siguruesit:** - Siguruesi nuk kërkon kthimin e shumës (rimbursim/regres) ndaj të siguruarit për dëmin e paguar palës të tretë.

**c. Parakusht për dëmshpërblim:** - Zbatimi i rreptë i kushteve të kontratës dhe anekseve është kusht paraprak për çdo detyrim të Siguruesit. - Nëse i siguruari **shkel kushtet** e kontratës, dëmshpërblimi **refuzohet automatikisht**.

#### 8. Ndryshime në Marrëdhëniet Ligjore të Sigurimit

**a. Ndallimi i kontratës:** - Kontrata konsiderohet e zgjidhur në rastet e mëposhtme: - **Ndryshim i pronësisë së mjetit. - Tërheqje e përkohshme ose e përhershme e mjetit** nga qarkullimi.

**b. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Siguruesi:** Siguruesi mund ta zgjidhë kontratën **menjëherë** me njoftim me shkrim nëse: - I siguruari **ka shkelur ndonjë nga kushtet** e përcaktuara. - Shkelja **nuk është korrigjuar brenda 30 ditëve** nga data e njoftimit.

**c. Pasojat e ndërprerjes/shkëputjes:** - Nuk bëhet **kthim i primit të sigurimit** në asnjë rast.

#### 9. Mbrojtja e të Dhënave Personale

1.Procesimi i të Dhënave: - Siguruesi proceson të dhënat personale të të Siguararit në përputhje me **Ligjin nr.124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"**; - Të dhënat përdoren **vetëm për qëllime të lidhura me ekzekutimin e kësaj kontrate** (vlerësimi i rrezikut, pagesa e dëmshpërblimeve, komunikime administrative), dhe proceseve të tjera të lidhura ngushtësisht me veprimtarinë e një shoqërie sigurimi

2.Ruatja dhe Siguria:- Të dhënat ruhen për **5 vjet pas skadimit të kontratës**, përveç rasteve kur ligji kërkon një periudhë më të gjatë. -Siguruesi garanton **masa teknike dhe organizative** për mbrojtjen e të dhënave nga hyrjet e paautorizuara.

3. Të Drejtat e të Siguararit: - E drejta për **akses, korrigjim, informim ose fshirje**, të të dhënave. - E drejta për të **kundërshtuar procesimin** e të dhënave për qëllime reklamimi.

#### 10. E Drejta e Ankimit

1.Procedura e Ankimit: - Çdo ankim në lidhje me zbatimin e kontratës paraqitet me shkrim në **adresën zyrtare të Siguruesit brenda 30 ditëve** nga data e ngjarjes së që sjell nevojës për ankim. - Siguruesi i përgjigjet brenda **15 ditëve kalendarike** nga marrja e ankimit.

2.Shkallë e Dytë e Ankimit: - Nëse ankimi nuk zgjidhet në mënyrë të kënaqshme, i Siguruari mund të drejtohet te **Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)**, sipas natyrës së çështjes.

#### 11. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj kontrate zgjidhet **paraprakisht me negociatë** midis palëve. Nëse negociatat dështojnë, çështja i referohet **Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Tiranë**, në përputhje me legjislacionin shqiptar. **Ligji aplikues:** Kontrata interpretohet dhe zbatohet sipas **Kodit Civil të Shqipërisë, Kodit Rrugor, dhe ligjeve specifike të sigurimeve**.

#### 12. Pranimi i Kushteve nga i Siguruari

Nënshkrimi i kësaj kontrate (fizik ose elektronik) konsiderohet **pranim i plotë dhe i pakushtëzuar** i të gjitha kushteve dhe anekseve.

I Siguruari deklaron se: - Ka lexuar dhe kuptuar të gjitha pika të kontratës. - Pranon detyrimin për pagesën e primit dhe respektimin e kushteve dhe se me pagesën e primit konsiderohen të njohura dhe pranuar kushte e kontrates sigurimit. - Ka autorizuar dhe dhënë pëlqimin për përpunimin dhe kontrollin e të dhënave personale për qëllim të kësaj kontrate sigurimi.

#### 13. Dispozita Finale

1.Ndryshimet në Kontratë:Çdo modifikim kërkon **marrëveshje me shkrim dhe nënshkrim të dy palëve**.

2.Marrëveshja e Plotë: Kjo kontrate përbën **marrëveshjen e plotë** midis palëve.

3.Hyrja në Fuqi: Kontrata hyn në fuqi **në datën e nënshkrimit** dhe pagesës primit sigurimit.